



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:004911

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05528561

KE.nr.2001/22

GJYKATA KOMERCIALE - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike civile të paditësit Nokia Corporation/ Karaportti 3, 02610 Espoo, FI, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Xh.R., me adresë në Rr. "Ndue Përlleshi", -Alko Impex, Ob.2-1/9, në Prishtinë kundër të paditurës Mobi Shop "Fita", SH.P.K., me adresë në Rr. "Bulevardi Dëshmorët e Kombit", 29 në Prishtinë, me NUI.811585316, të cilin e përfaqëson drejtori menaxhes/pronari Besart Fetahu, e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati L.M., me seli të zyrës në Prishtinë, për shkak të padisë për shkeljen e Markës Tregtare, jashtë seancës me datën 29.03.2024, morri këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSIDEROHET I TERHEQUR propozimi i paditësit Nokia Corporation/ Karaportti 3, 02610 Espoo, FI, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Xh.R., me adresë në Rr. "Ndue Përlleshi", -Alko Impex, Ob.2-1/9, në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paditësi Nokia Corporation/ Karaportti 3, 02610 Espoo, FI, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Xh.R., me adresë në Rr. "Ndue Përlleshi", -Alko Impex, Ob.2-1/9, në Prishtinë pranë kësaj gjykate me datën 12.01.2022, ka paraqitur padi për shkeljen e Markës Tregtare, me anë të së cilës ka kërkuar që gjykata ta aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesë padinë e paditësit dhe të vërtetohet se i padituri Mobi Shop "Fita", Sh.P.K ka bërë shkeljen e Markave Tregtare të paditësit, duke importuar produktin e falsifikuar dhe përdorimin e shenjës në mënyrë të pa autorizuar të 60-ë telefonave celularë të cilët posedojnë shenjën e regjistruar "Nokia" me Emai ndryshe nga origjinali, duke kërkuar që të paditurit t'i ndalohe në të ardhmen shkelja e Markës

Tregtare si dhe të obligohet që t'i kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore si dhe shpenzimet tjera lidhur me procedurën e asgjësimit të mallrave dhe qëndrimit të tyre në depo të Aeroportit të Prishtinës, e të gjitha këto nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Pas vlerësimit të shkresave të lëndës, kjo gjykatë ka caktuar dhe mbajtur disa seanca gjyqësore, mirëpo në seancën e caktuar me datën 18.03.2024, në orën 09:00, i autorizuari i palës paditëse, gjegjësisht avokati Xh.R. nuk ka prezantuar në seancë edhe pse seanca paraprake e datës 22.02.2024 ishte shtyrë me kërkesën e tij si pasojë e mos arritjes së dorëzimit të provave materiale të kërkuara nga gjykata, ndërsa në po të njëjtën ditë avokati Xh.R. kishte qenë në zyrë dhe në bashkëpunim me zyrën dhe të autorizuarin e palës së paditur avokatin L.M., ishte caktuar seanca e radhës për datën 18.03.2024, në orën 09:00.

Gjykata ka vlerësuar se i autorizuari i palës së paditur ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt andaj edhe ka vendosur që seanca të mbahet pa prezencën e tij në orën 09:20.

Gjatë seancës, i autorizuari i të paditurit avokati nga L.M., i ka propozuar gjykatës që të konsiderohet e tërhequr padia e paditësit, për faktin se propozuesi ishte ftuar në mënyrë të rregullt për të marrë pjesë dhe se nuk ka prezantuar në seancë.

Andaj, gjykata në vështrim të dispozitave të nenit 409 paragrafin 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *'Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet'* ka marrë aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr propozimin e paditësit Nokia Corporation/ Karaportti 3, 02610 Espoo, FI, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Xh.R., me adresë në Rr. "Ndue Përlleshi", -Alko Impex, Ob.2-1/9, në Prishtinë

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2001/22, datë 29.03.2024

Gjyqtari:

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.